



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Tiranë, më 6.2.2020

Lënda: Mbi denoncimin e ardhur në Institucionin e Komisionerëve Publikë

Denoncimi i znj.***.***, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ***, regjistruar në Institucionin e Komisionerëve Publikë në datën ***.12.2019, pas ankimit të Komisionerit Publik të datës 13.2.2019.

Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, mund të ketë lidhje të afërta të gjinisë me shtetasit ***.*** dhe ***.***, të cilët *mund të jenë persona me të shkuar kriminale*, fakte të njohura e të përhapura në qytetin e Beratit. Shtetasi ***.*** është i punësuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në detyrën e Sekretarit. Shtetasi ***.***, vëllai i shtetasit ***.***, është person me precedentë penalë, informacion që mund të konstatohet edhe nga kërkimi në *Google*.

Nisur nga pozita procedurale e posaçme, Komisioneri Publik, në rastin e këtij denoncimi, është në pamundësi për të mbledhur qoftë edhe indicie lidhur me këtë denoncim.

Nga aktet e administruara në format elektronik pranë IKP-së, konstatojmë se mungon: “Deklarata për kontrollin e figurës”, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, për të bërë verifikimin paraprak lidhur me sa pretendohet në denoncim për deklarimin apo jo të këtyre shtetasve në rubrikën përkatëse.

Referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, denoncimi konkret, në dukje, përmban të dhëna që mund të verifikohen paraprakisht në Deklaratën sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA